

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Njësia akademike:	Fakulteti Juridik – Universiteti i Prishtinës
Titulli i lëndës:	Teknika dhe taktika e hetimit të krimit
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I – Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Haki Demolli, Prof. Ass. Dr. Xhevdet Halili
Detajet kontaktuese:	hakidemolli@yahoo.com ; xhevdet.halili@gmail.com
Përshkrimi i lëndës	Studentët do të mësojnë për masat dhe veprimet operative taktike të cilat i zbatojnë organet shtetërore në luftën kundër krimit. Ndër mjetet dhe metodat kryesore që zbatohen në këtë luftë, janë daktiloskopia, balistika, traseologjia, grafologjia si dhe teknika e fotografisë. Ndërsa, si veprime të rëndësishme hetimore në këtë luftë janë këqyrja e vendit të ngjarjes, rikonstruimi i vendit të ngjarjes, ballafaqimi etj. Në kuadër të kësaj lënde do studentët do të mësojnë edhe për masat operative taktike si, përcjellja, prita, racia, patrullimi, vëzhgimi, kontrollimi i lokaleve, banesave, personave etj.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i lëndës është, që studentëve t'u ofrojë njohuritë e përgjithshme mbi mjetet dhe metodat teknike të cilat përdoren në shoqërinë bashkëkohore për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndriqimin e krimeve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje, që : 1. Të përkufizojë kuptimin e teknikës kriminalistike dhe ndarjen e saj; 2. Të përkufizojë kuptimin e taktikës kriminalistike dhe objektin e studimit të saj; 3. Të përcaktojë mjetet dhe metodat teknike që zbatohen në luftë kundër krimit bashkëkohor; 4. Të përcaktojë masat kryesore operative taktike

	që zbatohen në hetimin e krimit bashkëkohor; 5. Të planifikojë dhe zbatojë veprimet themelore që ndërmirren për hetimin e krimit bashkëkohor.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0,5-1	1	10
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	2	10	20
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	30	30
Përgaditja përfundimtare për provim	3	8	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet,prezentimet ,etj	2	5	10
Totali	5 ECTS	Total	150
Metodologjia e mësimëdhënies:			
Zakonisht do te aplikohën metoda bashkohore të ligjerimit, të cilat praktikohën në universitetët e ndryshme evropiane: prezentimi i temes përmes Power Point, raste studimi dhe detyra mesimore – studimore lidhur me temen e ligjeruar. Në disa raste atyre do të prezentohën edhe ligjerata autentike nga universitetet e ndryshme perendimore. Bashkëbisedim - duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me qështjët e ndryshme tematike. Aktivite të studentëve - studentët mund të përcaktohën për studimin e ndonjë teme apo punimi seminarik. Para fillimit të punës së tyre atyre ju ofrohën udhëzimet elementare, ndërsa pas përfundimit ju ofrohët mundësija e prezentimit të punimeve të tyre para studenteve te tjere. Pas prezentimit të ketyre seminareve zhvillohet debat interaktiv lidhur me temat			

	e shtjelluara dhe në fund behet vlersimi i punimit. Debat shkencorë - gjatë trajtimit të temave të ndryshme, studentët mund të ndahen në dy ose më shumë grupe, me qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore.														
Metodat e vlerësimit:	Mënyra e vlerësimit të studentit (në %) ▪ Punimi seminarik 0-10% ▪ Testi I 0-15 % ▪ Testi II 0-15% ▪ Provimi përfundimtar 0- 50% ▪ Pjesëmarrja në ushtrime 0 - 5% ▪ Puna grupore në detyra dhe raste studimi 0- 5% <table border="1"> <thead> <tr> <th>Vleresimi ne %</th><th>Nota perfundimtare</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>91-100</td><td>10 (dhjetë)</td></tr> <tr> <td>81-90</td><td>9 (nëntë)</td></tr> <tr> <td>71-80</td><td>8 (tetë)</td></tr> <tr> <td>61-70</td><td>7 (shtatë)</td></tr> <tr> <td>51-60</td><td>6 (gjashtë)</td></tr> <tr> <td>0-50</td><td>5 (pesë)</td></tr> </tbody> </table>	Vleresimi ne %	Nota perfundimtare	91-100	10 (dhjetë)	81-90	9 (nëntë)	71-80	8 (tetë)	61-70	7 (shtatë)	51-60	6 (gjashtë)	0-50	5 (pesë)
Vleresimi ne %	Nota perfundimtare														
91-100	10 (dhjetë)														
81-90	9 (nëntë)														
71-80	8 (tetë)														
61-70	7 (shtatë)														
51-60	6 (gjashtë)														
0-50	5 (pesë)														
Literatura															
Literatura bazë:	Kriminalistika, Një hyrje në shkencat ligjore, Richard Saferstein, Pearson Education, USA, 2014. Prof.dr. Skender Begeja: Taktika Kriminalistike, Tirane, 2001. Prof.dr. Vesel Latifi: Taktika Kriminalistike, Prishtinë, 2002. Prof.dr. Skender Begeja: Kriminalistika, Tirane, 2004. Prof.dr. Vladimir Vodinelic: Kriminalistika, Prishtinë, 1981.														
Literatura shtesë:	Kriminalistika, Nedžad Korajlić, Prishtinë, 2009. Ilir Mandro: Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë të zjarrit, Tiranë, 2000. Estref Myftari: Këqyrja e Vendit të ngjarjes, Tiranë, 1996. L. Prifti: Psikologjia e krimit, Tiranë, 2003. Vladimir Ikononi: Metodatat moderne në ekspertimin kriminalistik, Tiranë, 2004.														
Plani i dizajnuar i mësim:															
Java	Ligjerata që do të zhvillohet														

Java e parë:	-Kuptimi bazat shkencore dhe sistemi i taktikës kriminalistike; - Kuptimi i taktikës kriminalistike; - Sistemi i taktikës kriminalistike; - Bazat shkencore të taktikës kriminalistike; - Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër kriminalitetit.
Java e dytë:	Njohuritë e përgjithshme mbi teknikën kriminalistike; - Kuptimi dhe detyrat e teknikës kriminalistike - Ndarja e teknikës kriminalistike - Teknika regjistruese kriminalistike dhe regjistrimi kriminalistik - Zhvillimi i metodave të regjistrimit kriminalistik.
Java e tretë:	-Planifikimi i hetimit të veprave penale; - Kuptim dhe detyrat e planifikimit të hetimit; - Ngritja e versioneve hetimore- bazë e planifikimit; - Verifikimi i versioneve hetimore; - Hartimi i planit të hetimit; - Planifikimi i veprimeve hetimore.
Java e katërt:	-Mënyrat si bëhet informimi për përgatitjen dhe ekzistimin e veprës penale; - Informimi me anë të mjeteve të informimit publik; -Veprimtaria informative (spiunazhi) dhe policia.
Java e pestë:	Bazat e fotografisë kriminalistike - Kuptimi dhe llojet e fotografisë kriminalistike -Metodat kryesore të fotografisë kriminalistike - fotogrametria;
Java e gjashtë:	Taktika e marrjes së masave operative; - Kuptimi dhe llojet e verimtarisë operative; - Veprimtaria e gjurmimit.
Java e shtatë:	<i>Gjatë orës së parë do të bëhet vlerësimi i parë intermediar, përmes kollokviumit i cili do të përmbajë 20 pyetje që kanë të bëjnë me çështjet e ligjeruara në gjashtë ligjeratat e para.)</i> Gjatë orës së dytë të shtjellohen: - Masat operative të patrullimit, vëzhgimit, pritës dhe racisë; - Kuptimi dhe llojet e patrullimit; - Kuptimi i vëzhgimit; - Llojet e pritave; - Planifikimi dhe organizimi i masës operative të racisë.
Java e tetë:	Traseologjia dhe studimi mbi gjurmët - Kuptimi i gjurmëve në Kriminalistikë - Metodat e fiksimit të gjurmëve të veprës penale -Detyrat dhe parimet e traseologjisë.

Java e nëntë:	-Rëndësia dhe zbatimi I metodës së daktiloskopisë për hetimin e krimit -Historiku i daktiloskopisë - Karakteristikat e vijave papilare; - Ndarja e daktiloskopisë - Metodat e zbulimit dhe fikimit të vijave papilare.
Java e dhjetë:	- Taktika e zbatimit të masës së arrestit; - Ndjekja penale; - Kategorizmi i personave që duhet arrestuar; - Vendi i kryerjes së arrestit.
Java e njëmbëdhjetë:	- Taktika e kryerjes së kontrollimit; - Përgatitja për kontrollim; - Kontrollimi në banesa; - Kontrollimi i personave; - Fiksimi i rezultateve të kontrollimit.
Java e dymbëdhjetë:	- Kuptimi dhe ndarja e balistikës kriminalistike - Klasifikimi i armëve të zjarrit - Zbulimi dhe fiksimi i gjurmëve të armëve të zjarrit; -Përcaktimi i rrethanave të qitjes më armë të zjarrit - Ekspertimi balistik kriminalistik.
Java e trembëdhjetë:	- Taktika e këqyrjes së vendit të ngjarjes; - Kuptimi dhe detyrat e këqyrjes së vendit të ngjarjes; - Përgatitjet për këqyrjen e vendit të ngjarjes; - Puna e grupit hetimor në vendin e ngjarjes; - Fiksimi i rezultateve të këqyrjes së vendit të ngjarjes; - Skicimi i vendit të ngjarjes.
Java e katërmëdhjetë:	- Taktika e identifikimit me njohje e personave, kufomave dhe sendeve; - Kuptimi dhe rëndësia e identifikimit me njohje; - Përgatitja për identifikim me njohje; - Fiksimi I rezultateve të identifikimit me njohje. (Në orën e dytë bëhet vlerësimi i dytë intermediar).
Java e pesëmbëdhjetë:	- Mekanizmi I formimit të gjurmëve traseologjike; - Klasifikimi I gjurmëve - Gjurmët e veglave të thyerjes dhe mjeteve të transportit.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
E gjithë puna e studentit duhet të jetë e pavarur. Studentët duhet të njihen me Kodin etik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili kërkon që të gjithë, studentët dhe personeli akademik të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik. Mashtrimi, plagjiatura, gënjeshtria dhe vjedhja janë rreptësisht të ndaluara. Të gjitha shkeljet e Kodit Etik do t'i raportohen Komisionit disiplinor.	

